Nga shkresat e parashtruara dhe raportet e mjekëve shihet se Synavere Nicaj është e sëmurë dhe si pasojë e kësaj ka nevojë për blerjen e terapisë të cilat janë mjaftë të kushtueshme.

E përmendura është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe nuk ka asnjë burim të rregullt të të ardhurave dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake të bëjë blerjen e terapisë për shërim dhe në mungesë të mjeteve financiare përkrahet vetëm në shumë prej **150.00€ (njëqind e pesëdhjetë euro)**.

Në plan programin buxhetor të Drejtorisë për Shëndetësi, është përcaktuar edhe pozicioni subvencione dhe transfere, mjete nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale për shërim.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e tij në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapë konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Synavere Nicaj,
- Drejtorisë për Shëndetësi dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 znj.Zekije SUTAJ




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-518/022	Data: Datum: 25.07.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b), të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), bazuar në nenin 46, 47 dhe 48 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim shqyrtoi kërkesën: Nr.10-553-29012 të datës 13.07.2022 të parashtruar nga OJQ "Vision 02" nga Gurrakoci të cilën e përfaqëson Rexhë Mulaj, për përkrahje me karburant për realizimin e projektit: "Bashkëpunimi ndërkufitar për zhvillimin e raundit të parë të shkollës verore për zhvillimin e aktiviteteve multietnike- multikulturore dhe tradicional" dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.10-553-29012 e datës 13.07.2022, e parashtruar nga OJQ "Vision 02" të cilën e përfaqëson Rexhë Mulaj, për përkrahje me karburant për realizimin e projektit: "Bashkëpunimi ndërkufitar për zhvillimin e raundit të parë të shkollës verore për zhvillimin e aktiviteteve multietnike- multikulturore dhe tradicional" në Durrës aktivitetet do të realizohen 5 ditë në Republikën e Shqipërisë dhe përkrahet me **200 litra karburant** nga Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim.
2. Obligohet Zyrtari i Transportit "OJQ-Vision 02" të pajisë me vërtetim për furnizim me karburant në pajtim me procedurat të cilat vlejné për furnizim me karburant të automjeteve zyrtare, nga programi buxhetor i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe Zyrtari i Transportit.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

OJQ "Vision 02", ka parashtruar kërkesën Nr.10-553-29012 të datës 13.07.2022, për përkrahje me karburant për nevoja të OJQ "Vision 02" për realizimin e projektit: "Bashkëpunimi ndërkufitar për zhvillimin e raundit të parë të shkollës verore për zhvillimin e aktiviteteve multietnike- multikulturore dhe tradicional" në Durrës, aktivitetet do të realizohen 5 ditë në Republikën e Shqipërisë.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e OJQ "Vision 02" dhe të njëjtat i konsideron të arsyeshme dhe i miraton.

Duke parë rendësin e punës së OJQ "Vision 02" për realizimin e projektit: "Bashkëpunimi ndërkufitar për zhvillimin e raundit të parë të shkollës verore për zhvillimin e aktiviteteve multietnike- multikulturore dhe tradicional" në Durrës, aktivitetet do të realizohen 5 ditë në Republikën e Shqipërisë, OJQ "Vision 02" ka kërkuar 350 litra karburant, por në mungesë të mjeteve financiare përkrahet me **200 litra karburant** për realizimin e këtyre aktiviteteve.

Zyrtari i Transportit do ti pajisë me vërtetim për furnizim me karburante të lartpërmendurit nga programi buxhetor i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim në pajtim me procedurat që vlejné edhe për automjetet zyrtare.

Zyrtari i transportit kujdeset që të bëhet furnizimi me karburant dhe do të përcjellë realizimin e këtij Vendimi.

Për sa u tha me lartë u vendos si në diapozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hap konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Rexhë Mulaj- OJQ "Vision 02",
- Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ



Kryetari Komunës
z.Illir FERATI




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-520/2022	Data: Datum: 25.07.2022	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në bazë të nenit 46, 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin para Universitar të Republikës së Kosovë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.17/2011) dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Drejtoria Komunale për Arsim, shqyrtoi kërkesën 05 Nr.553-22900 të datës 07.06.2022, të parashtruar nga Bekim Hakaj, nga fsh. Orroberdë, Komuna e Istogut, për përkrahje me mjete fanaciare për udhëtim për vajzën Anduena Hakaj, dhe i propozoj Kryetarit me shkresë 05Nr.427/2022 të datës 15.06.2022 të nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa 05 Nr.553-2290 e datës 07.06.2022, e parashtruar nga Bekim Hakaj, nga fsh. Orroberdë, Komuna e Istogut, për përkrahje me mjete fanaciare për shpenzimet e udhëtimit për vajzën Anduena Hakaj dhe i ndahen mjete financiare në shumë prej **100.00€ (njëqind euro)** nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Drejtorisë Komunale për Arsim.
2. Mjetet e përcaktuara, në pikën 1. të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e Bekim Hakaj, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.
3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Komunale për Arsim.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Bekim Hakaj, ka parashtruar kërkesën 05 Nr.553-22900 të datës 07.06.2022, me të cilën ka kërkuar t'i ndahet mjete financiare për shpenzimet për udhëtim për vajzën Anduena Hakaj ne relacionin Orroberdë-Pejë. Kryetari shqyrtoi kërkesën e të lartpërmendurit dhe të njëjtin e konsideron te arsyeshme dhe e miraton. Nga shkresat e lendes dhe Vërtetimin e lëshuar SHMLT "Shaban Spahija" në Pejë me të cilit vërtetohet se Anduena është në klasën e XI-të për vitin shkollor 2021-2022 ka nevojë për përkrahje për shpenzimet e udhëtimit dhe për këtë arsye i ndihmohet me mjete financiare në shumë prej **(100.00€ (njëqind euro))**. Në planin e programit buxhetor të Drejtorisë Komunale për Arsim është përcaktuar edhe pozicioni i subvencioneve dhe transfereve, mjetet nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale. Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e Bekim Hakaj, në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Bekim Hakaj,
- Drejtorisë Komunale për Arsim dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj. Zekije SUTAJ




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-522/022	Data: Datum: 25.07.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) në nenin 46, 47 dhe 49 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) në nenin 68.1 pika 2. të Statutit të Komunës 01 Nr.62/10, dhe bazuar në nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, shqyrtoi kërkesën 01 Nr.400-17414 të datës 06.05.2022 të parashtruar nga Riza Mavraj për përkrahje financiare dhe i propozoi Kryetarit të nxjerrë:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa 01Nr.-400-17414 e datës 06.05.2022 e parashtruar nga Riza Mavraj dhe i ndahen mjete financiare në shumë prej **300.00€ (treqind euro)** nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, për organizimin e aktivitetit, për nderë të dëshmorit “Demush Mavraj” për vendin e parë ndahet kupa, ndahen 25 medalje, ndahen 15 medalje për veteranet e futbollit, 30 mirënjohje, 10 fletë-njoftime, fotot e dëshmoreve për medalje dhe fushën e futbollit, si në projekt propozim.

2. Mjetet e përcaktuara, në pikën 1. të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e djalit Artan Mavraj në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.

3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

4. Vendimi është përfundimtarë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Vendimi t'i dërgohet:

- Riza Mavraj,
- Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ

Zekije SUTAJ



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-523/022	Data: Datum: 25.07.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b), të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), bazuar në nenin 46, 47 dhe 48 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, shqyrtoi kërkesën 01 Nr.553-25649 të datës 24.06.2022 të parashtruar nga Betim Çetaj fsh. Trubohovc nga Komuna e Istogut, për përkrahje me karburant për të bërë transportin e trupës së baletit për të përformuar në ditën e çlirimit të Istogut dhe nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHEN:** 01 Nr.553-25649 e datës 24.06.2022 e parashtruar nga Betim Çetaj, për përkrahje me karburant për të bërë transportin për e trupës së baletit me koreograf Tasim Dajçi për të përformuar në ditën e çlirimit të Istogut dhe përkrahet me **90 litra karburant** nga programi buxhetor i Zyrës se Kryetarit..
2. Komuna e përkrah me karburant si në pikën 1 të këtij vendimi dhe obligohet Zyrtari i Transportit, të pajisë me vërtetim Betim Çetaj, në pajtim me procedurat të cilat vlejné për furnizim me karburant të automjeteve zyrtare.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Zyrtari i Transportit.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Betim Çetaj ka parashtruar kërkesën 01 Nr.553-25649 të datës 24.06.2022, për përkrahje me karburant për të bërë transportin e trupës së baletit me koreograf Tasim Dajçi për të përformuar në ditën e çlirimit të Istogut. Kryetari shqyrtoi kërkesën e Betim Çetaj dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Duke parë nevojën për rendësin e ditës se çlirimit të Istogut, përkrahen me 90 litra karburant dhe ky karburant për të bërë transportin e trupës së baletit.

Zyrtari i Transportit do ti pajisë Betim Çetaj me vërtetim për furnizim me karburant nga programi buxhetor i Zyrës se Kryetarit, në pajtim me procedurat që vlejné edhe për automjetet zyrtare.

Zyrtari i Transportit do të kujdeset që të bëhet furnizimi me karburant dhe do të përcjellë realizimin e këtij Vendimi.

Për sa u tha me lartë u vendos si në diapozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hap konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Betim Çetaj,
- Zyrtarit të Transportit dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj. Zekije SUTAJ




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-525/2022	Data: Datum: 25.07.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58, pika b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) në nenin 46, 47 dhe 49 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) në nenin 68.1 pika 2. të Statutit të Komunës 01 Nr.62/10, dhe bazuar në Rregullores MF-NR-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport, shqyrtoi kërkesën se bashku me projekt-propozimin 12 Nr.400-20819 të datës 26.05.2022 të parashtruar nga Ismet Demaj përfaqësues i OJQ-së “Folklori i Podgurit” për përkrahje financiare për manifestimin e “1 Qershori dita ndërkombëtare e fëmijëve” dhe i propozoi Kryetarit të nxjerrë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa 12 Nr.400-20819 të datës 26.05.2022 të parashtruar nga Ismet Demaj përfaqësues i OJQ-së “Folklori i Podgurit”, për përkrahje financiare për realizimin e projektit: “1 Qershori dita ndërkombëtare e fëmijëve” dhe i ndahen mjete financiare në shumë prej **250.00€ (dyqind pesëdhjetë euro)** nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport.
2. Mjetet e përcaktuara, në pikën 1. të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e OJQ “Folklori i Podgurit” në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.
3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.
4. Vendimi është përfundimtarë

A r s y e t i m

Ismet Demaj përfaqësues i OJQ-së “Folklori i Podgurit”, ka parashtruar kërkesën 12 Nr.400-20819 të datës 26.05.2022, për përkrahje financiare për realizimin e projektit: “1 Qershori dita ndërkombëtare e fëmijëve”. Kryetari shqyrtoi kërkesën e OJQ “Folklori i Podgurit” dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Përfaqësuesi i OJQ-së “Folklori i Podgurit”, ka kërkuar mjete financiare në shumë prej **500.00€**, por në mungesë të mjeteve financiare përkrahet financiarisht në shumë prej **250.00€** për shkak të rëndësisë së realizimin e projektit të cekur më lartë sipas projekt propozimit.

Në plan programin buxhetor të Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport është i përcaktuar pozicioni i subvencione dhe transfere, mjete nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë momentale.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e OJQ “Folklori i Podgurit”, në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- OJQ “Folklori i Podgurit”,
- Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ



Kryetari Komunës
z.Illir FERATI




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-526/022	Data: Datum: 25.07.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 46, 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare, shqyrtoi kërkesën 06 Nr.553-17216 të datës 05.05.2022 të parashtruar nga Alta Skoko, nga fsh.Dobrushë, Komuna e Istogut për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për prindin (Haso Erovic), dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa 06 Nr.553-17216, e datës 05.05.2022, e parashtruar nga Alta Skoko, për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për prindin (Haso Erovic) dhe me propozim të Komisionit i ndahen mjete financiare në shumë prej **200.00€ (dyqind euro)** nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi, si ndihmë momentale për shërim.
2. Mjetet e cekura do të transferohen në xhirollogarinë e Alta Skoko në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësi.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Alta Skoko, ka parashtruar kërkesën 06 Nr.553-17216, të datës 05.05.2022, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për blerjen e terapisë për prindin (Haso Erovic). Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton. Nga shkresat e parashtruara dhe raportet e mjekëve shihet se prindi Haso Erovic është i sëmurë dhe si pasojë e kësaj ka nevojë për blerjen e terapisë të cilat janë mjaftë të kushtueshme. E përmendura është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe nuk ka asnjë burim të rregullt të të ardhurave dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake të bëjë blerjen e terapisë për shërim e bashkëshortit dhe në mungesë të mjeteve financiare përkrahet vetëm në shumë prej **200.00€ (njëqind euro)**. Në plan programin buxhetor të Drejtorisë për Shëndetësi, është përcaktuar edhe pozicioni subvencione dhe transfere, mjete nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale për shërim. Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e tij në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Alta Skoko,
- Drejtorisë për Shëndetësi dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 znj.Zekije SUTAJ



Kryetari Komunës
 z.Illir FERATI




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-529/022	Data: Datum: 25.07.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar ne nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë Nr.28/2008), nenin 10 paragrafi 4 nenin 11 paragrafi 2 i Ligjit Nr.06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë Nr.13/2019), nenin 21 dhe 26 të Ligjit 05/L031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe nenin 31 të Statutit të Komunës së Istogut Nr.62/2010 i datës 30.11.2010, Zyrtarja për shqyrtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike shqyrtoj kërkesën 01-034-30907 të datës 21.07.2022 të parashtruar nga Demë Demaj nga Istogu për qasje në dokumente publike, i propozon verbalishtë Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

Për qasje në dokumente publike.

1. MIRATOHET: kërkesa 01-034-30907 e datës 21.07.2022 e parashtruar nga Demë Demaj si e bazuar për qasje në dokumente publike, me qëllim të sigurimit të një kopje të lejes ndërtimore të fqinjit Osman Salijaj dhe i lejohet qasja e plotë e të dhënave të lejes ndërtimore, si me poshtë:

1.1. Kopja e lejes ndërtimore të Osman Salijaj.

2. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Jeta Balaj-Imeraj-Zyrtare për shqyrtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike.

3. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Demë Demaj, ka parashtruar kërkesë 01-034-30907 të datës 21.07.2022 për qasje në dokumente publike, me qëllim të sigurimit të një kopje të lejes ndërtimore të fqinjit Osman Salijaj dhe i lejohet qasja e plotë e të dhënave të lejes ndërtimore.

Zyrtarja për shqyrtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike ka shqyrtuar kërkesën si të bazuar dhe pas analizimit dhe vlerësimit të kërkesës i propozoj verbalishtë Kryetarit të vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Kryetari e shqyrtoj propozimin verbal të Zyrtares për shqyrtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike dhe e miraton lejimin e qasjes në dokumente publike si në pikën 1 të këtij Vendimi.

Për sa u thë me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të paraqes ankesë në Agjencinë për Informim dhe Privatësi brenda 15 ditëve nga data e pranimi të tij.

Vendimi i dërgohet:

- Demë Demaj,
- Jeta Balaj-Imeraj-Zyrtare për shqyrtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj. Zekije SUTAJ




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-530/022	Data: Datum: 25.07.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë Nr.28/2008) dhe bazuar në nenin 7 paragrafi 1, nenin 6 paragrafi 6 të Udhëzimit Administrativ Nr.11/2010 për Licencimin e Qendrave Rinore i nxjerr nga Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport, shqyrtoj Raportin me rekomandime të Komisionit për shqyrtimin e kërkesave për licencimin e Qendrave Rinore të datës 08.07.2022 dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

Për Licencimin e Qendrës Rinore

1. **MIRATOHET:** Raporti me rekomandime të Komisionit për shqyrtimin e kërkesave për licencimin e Qendrave Rinore të datës 08.07.2022.
2. **Licencohet si Qender Rinore “Creative Youth Group” OJQ të cilën e përfaqëson Ermir Çitaku me seli në shtëpinë e kulturës “Adem Jashari” në Istog, kati i III.**
3. Obligohet Ermir Çitaku përfaqësues i OJQ-së “Creative Youth Group” që të udhëheqë Qendrën Rinore bazuar në Ligje dhe akte nënligjore në fuqi që rregullojnë këtë fushë si dhe obligohet që për aktivitetet e zhvilluara të bëjë raportë gjashtë mujore, vjetore dhe ti dërgoj në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport.
4. Obligohet Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport të mbikëqyrë udhëheqjen e Qendresë Rinore si dhe ti monitoron aktivitetet apo zhvillohen sipas planit të prezantuar gjatë konkurrimit për licencim.
5. Kontrata për Udhëheqje të Qendrës Rinore do të lidhet në afat tre (3) vjeçar.
6. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.
7. Vendimi është përfundimtarë.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendim pala e pakënaqur mund të parashtoj ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar me aktin administrativ dhe ti drejtohet Komisionit të ankesave në Ministrinë për Kulturë, Rini dhe Sport.

Vendimi i dërgohet:

- Ermir Çitaku përfaqësues i OJQ-së “Creative Youth Group”,
- Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ



Kryetari Komunës
z. Ilir FERATI




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-531/2022	Data: Datum: 26.07.2022	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në nenin 59 paragrafi 1 i Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.18/2011), në nenin 40 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja, shqyrtoj kërkesën e Prokurimit të datës 26.07.2022 për themelimin e Komisionit rivlerësues të tenderit për projektin: "Mirëmbatja e Objekteve në Institucionet Komunale (Komunë, Arsim dhe Shëndetësi) me numër të jashtëm prokurimi 633-022-4569-1-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-022-017-121, nxjerr:

V E N D I M

1.THEMELOHET: Komisioni rivlerësues i tenderit për projektin: "Mirëmbatja e Objekteve në Institucionet Komunale (Komunë, Arsim dhe Shëndetësi) me numër të jashtëm prokurimi 633-022-4569-1-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-022-017-121, dhe në komision caktohen:

- 1.1. **Naim Sadriu**, Zyrtar për Standarde, Monitorim dhe Vlerësim, Kryesues i Komisionit;
- 1.2. **Fisnik Shoshi**, Zyrtar Ligjor 2, anëtar dhe
- 1.3. **Agim Pacaj**, Zyrtar për Shërbim me Qytetar, anëtar.

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë rivlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në pajtim me kriteret e specifikuar në dosjen e tenderit për projektin: Mirëmbatja e Objekteve në Institucionet Komunale (Komunë, Arsim dhe Shëndetësi) me qëllim të konstatimit të tenderit të rivlerësuar si me i miri si dhe do t'i kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Të gjithë anëtarët e komisionit i nënshtrohen rreptësisht dispozitave të nenit 11 të LPP-së në lidhje me mbrojtjen e informave sekrete të ofertave.

4. Anëtarët e komisionit rivlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për rivlerësimin teknik të ofertës sipas nenit 40 paragrafi 40.3 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja.

5. Zyrtari përgjegjës i prokurimit do të organizoj, këshilloj dhe drejtoj punën e Komisionit rivlerësues dhe do të siguroj respektimin e dispozitave të LPP-së dhe Rregullave të Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja.

6. Obligohen anëtarët e komisionit që në afatin me të shkurtër kohor të prezantojnë pranë zyrës së Prokurimit dhe Prokurimi t'iu ofrojnë qasje në ofertave që kanë shprehur konkurrencë.

7. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni, Prokurimi dhe Drejtoria Komunale e Arsimit, Drejtoria për Shëndetësi dhe Drejtoria për Administrat Komunale.

8. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit,
- Prokurimit,
- Drejtorisë Komunale të Arsimit,
- Drejtorisë për Shëndetësi,
- Drejtorisë për Administrat Komunale dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ




Kryetari Komunës
z.Illir FERATI

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-532/2022	Data: Datum: 26.07.2022	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në nenin 59 paragrafi 1 i Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.18/2011), në nenin 40 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja, shqyrtoj kërkesën e Prokurimit të dorëzuar me datë 26.07.2022 për themelimin e Komisionit vlerësues të tenderit për projektin: “Servisimi dhe Mirembatja e Automejeteve të Zjarrfikseve” me numër të jashtëm prokurimi 633-022-6536-1-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-022-015R-121, nxjeri:

V E N D I M

1.THEMELOHET: Komisioni vlerësues i tenderit për projektin: “Servisimi dhe Mirembatja e Automejeteve të Zjarrfikseve” me numër të jashtëm prokurimi 633-022-6536-1-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-022-015R-121 dhe në komision caktohen:

- 1.1. Haki Belaj,** Inspektor për Parandalimin nga Zjarri, Kryesues i Komisionit;
- 1.2. Shfaqet Imeraj,** Zyrtar i Prokurimit², anëtar dhe
- 1.3. Sadik Kovačević,** Komandat i Shërbimit të Zjarrfikësve dhe Shpëtimit, anëtar.

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në pajtim me kriteret e specifikuar në dosjen e tenderit për projektin: “Servisimi dhe Mirembatja e Automejeteve të Zjarrfikseve” me qëllim të konstatimit të tenderit të vlerësuar si me i miri si dhe do t’i kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësit tjerë të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Të gjithë anëtarët e komisionit i nënshtrohen rreptësisht dispozitave të nenit 11 të LPP-së në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete të ofertave.

4. Anëtarët e komisionit vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin teknik të ofertës sipas nenit 40 paragrafi 40.3 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja.

5. Zyrtari përgjegjës i prokurimit do të organizoj, këshilloj dhe drejtoj punën e Komisionit vlerësues dhe do të siguroj respektimin e dispozitave të LPP-së dhe Rregullave të Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja.

6. Obligohen anëtarët e komisionit që në afatin me të shkurtër kohor të prezantojnë pranë zyrës së Prokurimit dhe Prokurimi t’iu ofroj qasje në ofertave që kanë shprehur konkurrencë.

7. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni, Prokurimi dhe Drejtorisë për Emergjencë.

8. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit,
- Prokurimit,
- Drejtorisë për Emergjencë dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ



Kryetari Komunës
z.Illir FERATI




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-537/022	Data: Datum: 26.07.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58. pika b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) në nenin 46, 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) në nenin 68.1 pika 2. të Statutit të Komunës 01 Nr.62/10, dhe bazuar në neni 1 të Rregullores 01 Nr.42/2014 për Ndarjen e Subvencioneve, shqyrtoi kërkesën se bashku me projekt-propozimin Nr.01-400-15056 të datës 19.04.2021 të parashtruar nga “Klubi Letrar Podguri” të cilën e përfaqëson Nuredin Imeraj, për përkrahje financiare, nxjerrë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.01-400-15056 e datës 19.04.2022, e parashtruar nga “Klubi Letrar Podguri” dhe i ndahen mjete financiare për realizimin e projektit: Shpallja e Istogut “Qyteti i Paqes” dhe i ndahen mjete financiare në shumë prej **450.00€ (katërqind e pesëdhjetë euro)** nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.
2. Mjetet e përcaktuara, në pikën 1. të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e “Klubit Letrar Podguri” në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.
3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.
4. Vendimi është përfundimtarë.

A r s y e t i m

“Klubi Letrar Podguri” ka parashtruar kërkesën Nr.01-400-15056 të datës 19.04.2022, për përkrahje financiare për realizimin e projektit: Shpallja e Istogut “Qyteti i Paqes”.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e “Klubit Letrar Podguri”, dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton. Klubi Letrar Podguri ka kërkuar mjete financiare në shumë prej **480.00€**, por në mungesë të mjeteve financiare përkrahet financiarisht në shumë prej **450.00€** për shkak të rëndësisë së realizimit të projektit: për shpalljen e Istogut “Qyteti i Paqes”, sipas tabelës së buxhetit për shpenzime të paraqitura në projekt-propozim.

Në plan programin buxhetor të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport. është përcaktuar edhe pozicioni i subvencioneve dhe transfereve, mjete nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë momentale.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t’i transferohen në xhirollogarinë e Klubit Letrar Podguri në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Klubi Letrar Podguri,
- Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ



Kryetari Komunës
z.Illir FERATI




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-540/2022	Data: Datum: 26.07.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008), bazuar në nenin 81 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068, Ligjin Nr.05/L-092, bazuar në Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja, shqyrtoj kërkesën e Prokurimit të datës 18.07.2022, për caktimin e Menaxherit të kontratës dhe Mbikëqyrësit të drejtpërdrejt të Menaxherit të kontratës për projektin: Loto1“Mirëmbajtja e rrugëve malore-zona Radushë”, nxjerr:

V E N D I M

1. **CAKTOHET:** Menaxher i kontratës **z.Xhevat Idrizaj**, Zyrtar për Pylltari 2 dhe Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës **CAKTOHET: z.Astrit Hajrizaj**, Drejtorë i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi për projektin: Lot1 “Mirëmbajtja e rrugëve malore-zona Radushë”, me numër të jashtëm prokurimi 633-22-1118-5-2-1 dhe me numër të brendshëm prokurimi 633-022-006-521, të cilin projekt e ka fituar për ta realizuar operatori **“Te Aleni” SH.P.K** me seli në Vrellë, Komuna e Istogut.
2. Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës obligohet që të bëjë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës duke zbatuar nenin 61 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01, si dhe Manualët për Përdorim të Modulit për Menaxhim të Kontratës.
3. Përgjegjësin për realizimin e projektit të lartcekur e marr Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës.
4. Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit dhe fillon të zbatohet menjëherë.
5. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- zXhevat Idrizaj-Menaxher i kontratës,
- zAstrit Hajrizaj-Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj. Zekije SUTAJ



Kryetari Komunës-ZKA
z.Illir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-541/022	Data: Datum: 26.07.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 46, 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nën 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 dhe nën 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare, shqyrtoi kërkesën, 06 Nr.553-14403 të datës 13.04.2022 të parashtruar nga Synavere Salijaj, nga Istogu, Komuna e Istogut për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërim, dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa 06 Nr.553-14403, e datës 13.04.2022 e parashtruar nga Synavere Salijaj, për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërim dhe me propozim të Komisionit i ndahen mjete financiare në shumë prej **200.00€ (dyqind euro)** nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi, si ndihmë momentale për shërim.
2. Mjetet e cekura do të transferohen në xhirollogarinë e Synavere Salijaj, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësisë.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Synavere Salijaj, ka parashtruar kërkesën 06 Nr.553-14403, të datës 13.04.2022, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për blerjen e terapisë për shërim.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Nga shkresat e parashtruara dhe raportet e mjekëve shihet se Synavere Salijaj është e sëmurë dhe si pasojë e kësaj ka nevojë për blerjen e terapisë të cilat janë mjaftë të kushtueshme.

E përmendura është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe nuk ka asnjë burim të rregullt të të ardhurave dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake të bëjë blerjen e terapisë për shërim dhe në mungesë të mjeteve financiare përkrahet vetëm në shumë prej **200.00€ (dyqind euro)**.

Në plan programin buxhetor të Drejtorisë për Shëndetësi, është përcaktuar edhe pozicioni subvencione dhe transfere, mjete nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale për shërim.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e tij në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Synavere Salijaj,
- Drejtorisë për Shëndetësi dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01- 542/022	Data: Datum: 26.07.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 46, 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare, shqyrtoi kërkesën 06 Nr.553-16053 të datës 26.04.2022 të parashtruar nga Shaban Haziraj, nga fsh.Uçë, Komuna e Istogut për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërim, dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa 06 Nr.553-16053, e datës 26.04.2022 e parashtruar nga Shaban Haziraj, për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërim dhe me propozim të Komisionit i ndahen mjete financiare në shumë prej **150.00€ (njëqindpesedhjetë euro)** nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi, si ndihmë momentale për shërim.
2. Mjetet e cekura do të transferohen në xhirollogarinë e Shaban Haziraj në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësisë.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Shaban Haziraj, ka parashtruar kërkesën 06 Nr.553-16053, të datës 26.04.2022, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për blerjen e terapisë për shërim.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton. Nga shkresat e parashtruara dhe raportet e mjekëve shihet se Shaban Haziraj, është i sëmurë dhe si pasojë e kësaj ka nevojë për blerjen e terapisë të cilat janë mjaftë të kushtueshme.

I përmenduri është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe nuk ka asnjë burim të rregullt të të ardhurave dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake të bëjë blerjen e terapinë për shërim dhe në mungesë të mjeteve financiare përkrahet vetëm në shumë prej **150.00€ (njëqindpesedhjetë euro)**.

Në plan programin buxhetor të Drejtorisë për Shëndetësi, është përcaktuar edhe pozicioni subvencione dhe transfere, mjete nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale për shërim.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e tij në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- PShaban Haziraj,
- Drejtorisë për Shëndetësi dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 znj.Zekije SUTAJ





 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-543/2022	Data: Datum: 26.07.2022	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në nenin 59 paragrafi 1 i Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.18/2011), në nenin 40 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja, shqyrtoj kërkesën e Prokurimit të datës 22.07.2022 për themelimin e Komisionit vlerësues të tenderit për projektet: Lot1 "Ndërtimi i ndriçimit publik në Istog", Lot2 "Ndërtimi i ndriçimit publik në Staradran", Lot3 "Ndërtimi i ndriçimit publik në Cerrcë", Lot4 "Ndërtimi i ndriçimit publik në Tomoc me numër të jashtëm prokurimi 633-022-6576-5-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-022-032-521, nxjerr:

V E N D I M

1.THEMELOHET: Komisioni vlerësues i tenderit për projektet: Lot1 "Ndërtimi i ndriçimit publik në Istog", Lot2 "Ndërtimi i ndriçimit publik në Staradran", Lot3 "Ndërtimi i ndriçimit publik në Cerrcë", Lot4 "Ndërtimi i ndriçimit publik në Tomoc me numër të jashtëm prokurimi 633-022-6576-5-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-022-032-521, dhe në komision caktohen:

- 1.1. Rasim Mahmotoviq,** Udhëheqës i Sektorit për Komunitete dhe Kthim, Kryesues i Komisionit;
- 1.2. Naser Gjoci,** Udhëheqës i Sektorit për Shërbime Publike, anëtar dhe
- 1.3. Shefqet Imeraj,** Zyrtar i Prokurimit 2, anëtar.

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në pajtim me kriteret e specifikuar në dosjen e tenderit: Lot1 "Ndërtimi i ndriçimit publik në Istog", Lot2 "Ndërtimi i ndriçimit publik në Staradran", Lot3 "Ndërtimi i ndriçimit publik në Cerrcë", Lot4 "Ndërtimi i ndriçimit publik në Tomoc" me qëllim të konstatimit të tenderit të vlerësuar si me i miri si dhe do t'i kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Të gjithë anëtarët e komisionit i nënshtrohen rreptësishtë dispozitave të nenit 11 të LPP-së në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete të ofertave.

4. Anëtarët e komisionit vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin teknik të ofertës sipas nenit 40 paragrafi 40.3 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja.

5. Zyrtari përgjegjës i prokurimit do të organizoj, këshilloj dhe drejtoj punën e Komisionit vlerësues dhe do të siguroj respektimin e dispozitave të LPP-së dhe Rregullave të Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja.

6. Obligohen anëtarët e komisionit që në afatin me të shkurtër kohor të prezantojnë pranë zyrës së Prokurimit dhe Prokurimi t'iu ofroj qasje në ofertave që kanë shprehur konkurrencë.

7. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni, Prokurimi dhe Drejtorisë për Shërbime Publike.

8. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit,
- Prokurimit,
- Drejtorisë për Shërbime Publike dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01- 544/2022	Data: Datum: 26.07.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 46, 47. dhe 48. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, shqyrtoi kërkesën Nr.06-553-31057, të datës 21.07.2022, të parashtruar nga z.Sulo Ahmetaj, nga fsh.Cerrcë, Komuna e Istogut, për përkrahje me karburant për dërgimin e tij në QKUK në Prishtinë dhe i propozon Kryetarit të nxjerri:

V E N D I M

